

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Watch Construction shpk**

Ne Tirane, sot ne date 1.Janar. 2021 ;

Une z.Enis Tufina i biri i Jusuf-it, lindur ne Tirane me date 29.08.1973 dhe banues ne Gabriel-Von-Seidl-Str.4582031 Grunwald Deutschland, identifikuar me pasaporten nr. CHPLOK7R3 e vlefshme deri me datë 17.09.2023 , madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Me cilesine e ortakut te vetem, kam redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, per krijimin e shoqërise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Watch Construction Shpk", në respektim te Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit", i ndryshuar , sikur vijon :

Neni 1 Emertimi i Shoqerise

- 1.1 Shoqeria e emertuar Watch Construction shpk (me poshte e quajtur "Shoqeria"), eshte një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- 1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 2 Selia

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Ali Demi, Ambientet e ish-Kombinatit Poligrafik, Godinë 2 katëshe, ngjitur me Spitalin Continental, prone e Kryegjyshatës Bektashiane, Tiranë, Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjesë ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, qofte brenda apo jashtë territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me vendimet e asamblese se ortakeve.

Neni 3 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 4 Objekti

Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise do te jetë:

Ndërtim i objekteve civile dhe industriale, rrugëve, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, tunele, vepra turistike, bujqësore, ndërtimi i ndërtimesave, zyrave, porteve,

aeroporteve, veprave energetike, ujësjellesa dhe kanalizimeve, kulla, kulla uji, guore, veshje fasadash, pastrim të sipërfaqes urbane, prodhim inertesh, shfrytëzim e përpunim i materialeve të shtratit të lumenjve si edhe çdo vepre tjeter me qëllim ndërtimi. Përfshihen edhe kompletimet me instalimet e nevojshme, riparimet dhe restaurimet e këtyre objekteve. Prodhim, përpunim, shitje dhe blerje betoni. Ndërtim i linjave dhe fabrikave për prodhimin e materialeve të ndërtimit, të inerteve, soletave të pararendura, tullave, tjegullave, pllakave majolike, tregtim e transport i tyre. Ndërtim rrugësh, veprash e objektesh infrastrukturore të kategorive të ndryshme duke përfshirë veshje me asfalto beton dhe sistemi asfaltilimi. Promovimin dhe realizimin e investimeve dhe punimeve ndërtimore të të gjitha kategorive, duke përfshirë por pa u kufizuar në punime ndërtimore si punime dhei, gërmime, pastrime, sistemime, tarracime terrenesh, etj. Prodhim material inerte, rërë, cakall, gurë, mermere, etj. Prodhim elementesh të parafabrikuara, betoni e beton arme. Import, eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vetë shoqërisë apo të tretëve të materialeve të ndërtimit, produkteve industriale, makinerive, pajisjeve e pjesë këmbimi të tyre, lëndëve të para, produkteve të gatshme e gjysëm të gatshme, mineraleve. Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të skrapit dhe metaleve me ngjyrë. Transport kombëtar e ndërkombëtar në rrugë detare, tokësore, apo ajrore të të gjitha llojeve të mallrave të lejuara nga legjislacioni shqiptar dhe të huaj në fuqi. Shitblerjen dhe riparimin e pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit dhe mjeteve rrugore për nevojat e shoqërisë dhe të të tretëve. Blerja dhe shitja e automjeteve të reja e të përdorura Kërkim, zbulim mineralesh, hapje dhe shfrytëzim minierash, pasurime industriale të minierave, mbyllje punimesh dhe rehabilitim ambienti në minierat e shuara ose të konservuara, ndërtim impiante fraksionimi e betoni, si dhe çdo lloj aktiviteti tjeter lidhur me karriera të çdo lloj tipi dhe cilësie në Republikën e Shqipërisë. Punime me lëndë plasëse në objekte infrastrukturore, ndërtimore e minerare. Konsulencë në fusha të ndryshme, supervizion, menaxhime, studime e projekteve të të gjitha llojeve, vleresime tekniko - ekonomike, konsulencë dhe ndërmjetësim për lidhje dhe zbatim kontratash, marrëveshjesh të ndryshme, ortakërish, shoqërishë të përbashkëta apo forma të tjera, veprimtari komisionere, përfaqësim, si dhe veprime të tjera të porositura nga të tretët të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Konsulencë, revizion, ekspertizë, vleresime të kapitaleve dhe gjendjes së shoqërive, planbiznese, projekte zhvillimi dhe studime të efektiviteteve ekonomike, përcaktimi i prioriteteve në fusha të ndryshme të ekonomisë etj., administrim fondesh dhe/ose investimesh etj. Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukturës dhe /ose të pjesëve përbërëse të saj, për shfrytëzimin njerëzor me karakter pushues, argëtues, edukues dhe/ose kurues; të burimeve natyrore, kulturore, mijedisore kurative, të Shqipërisë dhe më gjërë. Tregtimin, dhënien e marrjen me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme të veta ose të të tretëve, edhe të mobiluara, etj. Ndërmjetësim në të gjitha fushat e sektorët ekonomik të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në fushën e mijdisit shoqëria do të kryejë: studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të mbrojtjes dhe ose përmirësimit si dhe rehabilitimit të kushteve të mijdisit rrethues; përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjeter, trajtimi i ujrale industrial, projektimin, mbikqyrjen në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftësimin dhe trajtimin e tokave të kripura e kënetave si dhe çdo veprimtari tjeter mijedisore që ka rëndësi për shoqërinë. Në fushën e telekomunikacionit shoqëria do të kryejë: studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin e impianteve të telekomunikacionit dhe shërbimet e ndërlidhjes në internet, administrimi, vendosja dhe përdorimi i impianteve fiksë dhe të lëvizshme për transmetime radiotelevizive e mjete të tjera komunikimi. Shoqëria ka të gjitha të drejtat për të marrë pjesë në fitimet dhe/ose në shoqëri të tjera të së drejtës shqiptare ose të shteteve të tjera dhe të themelojë e të kryej çdo tjeter veprim

juridik të njojur nga legjilacioni në fuqi me shoqëri të tjera, me persona fizikë ose juridikë, publik ose privat, vendas ose të huaj. Gjithashtu, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj shërbimi apo aktiviteti ndërtimi, tregtar, financiar, konsulencë, qiradhënës apo dorëzanës, që i lejohet një shoqërie me përgjegjësi të kufienguar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të veprimitarisë së saj”.

Neni 5 Kapitali

- 5.1 Kapitali i Shoqerise eshte 800,000 (teteqinde mijë) EUR, i ndare ne 1 (nje) kuote, vlera e te cilave zoterohet nga Ortaket si me poshte:
- **Enis Tufina**, mbajtes i 1(nje) kuote, e cila perfaqeson 100% te kapitalit me vleren 800,000 (teteqinde mijë) EUR;
- 5.2 Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne çdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen ne ligjin shqiptar. Pergjegjesia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

Neni 6 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

6.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise. Ajo perfaqeson te gjithe ortaket dhe vendimet e saj, të marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, Jane detyruese per te gjithe ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve, ajo mblidhet ne selin e saj apo ne cdo vend tjeter .

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te si me poshte vijon :

- a) percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
- b) miratimi i ndryshimeve te statutit;
- c) emerimi e shkarkimi i anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tyre;
- d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
- e) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Keshilli Administrativ/Administratori i Vetem, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
- g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
- h) pjesetimin e kuotave, anulimin e tyre, largimin e ortakut, ndarjen e fitimit ne perputhje me perqindjet e kuotave ose jo, kjo ne marveshje me ortaket;

- i) caktimin e perfaquesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem;
- j) miratimin e riorganizimit te Shoqerise, perfshire bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen e Shoqerise, shnderrimin e Shoqerise si dhe prishjen e Shoqerise;
- k) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.
- l) ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji apo statuti.

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese duke patur te drejten e votes ne raport me vleren nominale te kuotes se tij. Çdo ortak mund te perfaquesohet ne vendimarrje nga nje ortak tjeter, nga bashkeshori(ja) ose nga çdo person tjeter, me kushtin qe perfaquesuesit te jene te pajisur me autorizimin per ate qellim. Administratoret e shoqerise nuk mund te jene perfaquesues te ortakeve ne mbledhjet e Asamblese se Ortakeve. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se ortakeve, por perfshin edhe mbledhjet me te njejtin rend dite.

6.2 Administratori(et) sipas gjykimit te tij te lire ose me kerkesen e nje dhe/ose me shume ortakeve te cilet perfaquesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise dhe/ose auditit ligjor nese ka, dhe/ose likuiduesit kane te drejte te therrasin Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve. Ne kete rast ortakeve duhet t'iu dergohet nje njoftim me shkrim per mbledhjen me postë elektronike (email) jo me vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes, i cili thekson qellimin, vendin dhe oren e mbledhjes. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit brenda 6 muajve nga perfundimi i vitit ushtrimor.

6.3 Perveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te numrit total te votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakut pjesëmarrës.

Per te vendosur shperndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistuar, anulimin, fshirjen e kuotes, largimin e ortakut si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur jane te pranishem ose te perfaquesuar ortaket qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjete perqind) te numrit total te votave. Vendimi merret me voten pro te te pakten 75% (shtatedhjete e pese) perqind te ortakeve te pranishem. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuorumit te percaktuar me lart, ajo mblidhet perseri, por jo me vone se 30 (tridhjete) dite, me te njejtin rend dite.

Neni 7 Administrimi i Shoqerise

- 7.1 Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga Administratori.
- 7.2 Administratori emerohet me vendim te Ortakeve dhe qendron ne kete detyre per nje afat jo me te gjate se 5(pese)vjet. Administratori mund te rizgjidhet per te njejten periudhe me vendim te Ortakevete shoqerise.
- 7.3 Administrator i Shoqerise do te jete:

z.Enis Tufina, i datelindjes 29.08.1973 , lindur ne Tirane dhe banues ne ne Gabriel- Von-Seidl-Str.4582031 Grunwald Deutschland, identifikuar me pasaporten nr. CHPLOK7R3 e vlefshme deri me date 17.09.2023 (me adrese ne Tirane prane selise se shoqerise).

Administratori mund te shkarkohet me me vendim te ortakeve ne çdo moment per arsyte te justifikuara.

- 7.4 Administratori eshte personalisht perjegjes perpara Shoqerise dhe/ose paleve te treta per deme te shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ketij Statuti ose te Ligjit.

Neni 8 Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit

- 8.1 Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqerise do te administrohen nga Administratori, i cili ka te drejte te ushtroje te gjitha kompetencat qe gjykon te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakeve te Shoqerise. Administratori mundte autorizoje apo emeroje me ane te prokures persona te trete per kryerjen e veprimtarive dhe/ose kompetencave qe i perkasin Administratoreve.
- 8.2 Kompetencat e Administratorit ne lidhje me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise percaktohen por pa u kufizuar, si me poshte vijon.
- (a) Te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
 - (b) Te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standartet kontabel;
 - (c) Te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise;
 - (d) Te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve/ose autoriteteteve vendase ose te huaja;
 - (e) Te perqatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerisete cilat do te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
 - (f) Te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te ne fuqi;
 - (g) T'i raportoje Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te veçante per Shoqerine;
 - (h) Te punesoje dhe te shkarkoje punonjes sipas politikave te shoqerise;
 - (i) Te hartoje dhe te nenshkruaje deklaratat tatimore dhe cdo akt tjeter qe ka lidhje me dokumentacionin qe duhet te dorezohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ose autoriteteteve te tjera. Te kryej detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

Neni 9 Auditimi dhe viti ushtrimor

- 9.1 Auditit Ligjor do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Pegjithshme te Ortakeve ne rastet kur kjo eshte kerkese e legjislacionit shqiptar. Riemerimi do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Auditit Ligjor mund te shkarkohen me vendim te ortakut te

vetem apo Asamblese se Ortakeve per shkelje te detyrave, gabime dhe sjelljes jo te mire profesionale.

- 9.2 Viti ushtrimor fillon ne 1.Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar(QKB) dhe perfundon me date 31 Dhjetor 2021 .

Neni 10 Shperndarja dhe Prishja

- 10.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.
- 10.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, i cili do te sherbeje per qellimet e likuidimit dhe emrin e shoqerise do ta pasojne fjalet “ne proçes likuidimi”
- 10.3 Likudatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatorit(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 11 Ligji i Zbatueshem

- 11.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.
- 11.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar per shoqerite tregtare.
- 11.3 Per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe paleve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

Neni 12 Ndryshimet

Statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar Watch Construction shpk, mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me një statut te ri me vendim te ortakut te vetem apo Asamblese se Ortakeve. Statutit hartohet ne 3(tre) kopje ne gjuhen shqipe, me vlera te njejtë secila.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Watch Construction shpk

Enis Tuftina

